THIS PAPER AIMS TO ANALYSE IN DETAIL THE ASPECTS OF LEXICO-GRAMMATICAL UNITS WITH NOMINAL AND ADJECTIVAL VALUES WITHIN THE FRAMEWORK OF BILINGUAL FRENCH-ALBANIAN LEXICOGRAPHY

ASPEKTE TË BARASVLERËS STRUKTURORE DHE SEMANTIKE TË NJËSIVE FRAZEOLOGJIKE ME VLERË EMËRORE DHE MBIEMËRORE NË LEKSIKOGRAFINË FRËNGJISHT- SHQIP

Shejnaze AJDINI-MURTEZI,[1] Dëfrim SALIU[2]

[1] Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje*
[2] Department of French Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova
[*]Corresponding author e-mail: shejnaze.ajdini@unite.edu.mk

Abstract

The focus of this study is the examination of the relations between the two languages, highlighting the challenges and strategies followed by lexicographers and translators during the process of transitioning from the source language to the target language. Through analytical and contrastive methods, this research sheds light on the lexico-grammatical and semantic similarities and differences that exist between these expressions with nominal and adjectival values, as well as their equivalences resulting from the interaction of two different cultural contexts. To achieve this goal and facilitate the comparative analysis, the selected phraseological units are classified into five main categories: units with full equivalence, partial equivalence, zero equivalence (lack of equivalence), units conveyed through paraphrasing, and literally translated idioms. The conclusions of this paper aim to contribute to enriching bilingual lexicographical practices and deepening the understanding of cultural and linguistic transfer between French and Albanian.

Keywords: phraseological units, equivalence, lexico-grammatical, semantic, French, Albanian.

Përmbledhje

Ky punim ka për qëllim të analizojë në mënyrë të detajuar aspektet e barasvlerës leksiko-gramatikore dhe semantike të njësive frazeologjike me vlerë emërore dhe mbiemërore në kuadër të leksikografisë dygjuhëshe frëngjisht-shqip. Në fokus të këtij studimi është shqyrtimi i raporteve ndërmjet dy gjuhëve, duke evidentuar sfidat dhe strategjitë që ndjekin leksikografët dhe përkthyesit gjatë procesit të kalimit nga gjuha burimore në gjuhën e synuar. Përmes metodës analitike dhe kontrastive, në këtë hulumtim vihen në pah ngjashmëritë dhe dallimet leksiko-gramatikore e semantike që ekzistojnë midis këtyre shprehjeve me vlerë emërore e mbiemërore, si dhe ekuivalencat e tyre që dalin si rrjedhojë e ndërveprimit të dy konteksteve të ndryshme kulturore.
Për të arritur këtë synim dhe për të lehtësuar analizën krahasuese, njësitë frazeologjike të përzgjedhura janë klasifikuar në pesë kategori kryesore: njësi me përputhje të plotë, me përputhje të pjesshme, me përputhje zero (mungesë ekuivalence), njësi të përcjella përmes parafrazimit, si dhe idioma të përkthyera fjalë për fjalë. Përfundimet e këtij punimi synojnë të ndihmojnë në pasurimin e praktikave leksikografike dygjuhëshe dhe në thellimin e kuptueshmërisë mbi bartjen kulturore dhe gjuhësore mes frëngjishtes dhe shqipes.

***Fjalët kyçe*:** njësi frazeologjike, barasvlerë, leksiko-gramatikore, semantike, frëngjisht, shqip.

Hyrje

Njësitë frazeologjike janë togfjalësha të qëndrueshëm, kuptimi i të cilëve shpesh nuk mund të përcaktohet vetëm nga kuptimi i veçantë i përbërësve të tyre. Ato karakterizohen nga qëndrueshmëria strukturore, veçantia semantike dhe përdorimi i tyre i konsoliduar në komunikimin gjuhësor. Përmes këtyre njësive, gjuha fiton shprehësi, figurshmëri dhe ngjyrim emocional, duke e bërë komunikimin më të pasur dhe më të natyrshëm.

https://doi.org/10.62792/ut.icfra.y2026.i2.pp149

Një çështje me rëndësi të veçantë në studimin e frazeologjisë është barasvlera strukturore dhe semantike e njësive frazeologjike në gjuhë të ndryshme. Ky aspekt lidhet me mundësinë e identifikimit të njësive frazeologjike që, pavarësisht dallimeve në ndërtimin e tyre gjuhësor, shprehin kuptime të njëjta ose të përafërta. Barasvlera strukturore ka të bëjë me ngjashmëritë ose dallimet në përbërjen dhe organizimin e elementeve të një njësie frazeologjike, ndërsa barasvlera semantike lidhet me përputhjen e kuptimit që këto njësi përcjellin.

Njësi frazeologjike me kuptim dhe strukturë identike

Shprehja frazeologjike emërore

shqip / barasvlera në shqip / Kuptimi

le talon d'Achille / thembra e Akilit / tregon cenueshmërinë ose dobësinë e fshehur

të një njeriu, një plani, një organizate apo një sistemi,

la boîte de Pandore / kutia e Pandorës / të bësh një veprim në dukje të vogël , por që çon në një zinxhir pasojash të mëdha.

pomme de discorde / mollë sherri / fjalë, send ose veprim që sjell një grindje, përçarje ose mosmarrëveshje midis njerëzve

vie de chien / jetë qeni / jetë e rëndë, e mundimshme

mauvaise graine / farë e keqe / njeri i keq, i pandreqshëm, keqbërës

larmes de crocodile / lotë krokodili / simbolizon hipokrizinë, keqardhjen e rreme ose dhembshurinë e shtirur.

pierre angulaire / gur themeli / diçka shumë e rëndësishme dhe e qëndrueshme që shërben si mbështetje për diçka tjetër

Shprehja frazeologjike mbiemërore / Barasvlera në shqip / Kuptimi

blanc comme neige / i bardhë si bora / pastërti fizike ; pastërti morale ; pafajësi

solide comme un roc / i fortë si shkëmbi (guri) / shumë i fortë

doux comme un agneau / i butë si qengj / i urtë, i sjellshëm, paqedashës

fier comme un paon / krenar si një pallua / mendjemadh, arrogant

con comme la lune / rrotë nga mendja / njeri i trashë nga mendja

Njësi frazeologjike me kuptim identik , por me strukturë të ndryshme

Shprehja frazeologjike emërore

frëngjisht	shqip	kuptim
bouc émissaire	/ *kokë turku (dashi i kurbanit)* /	ai të cilit i ngarkohet faji i të tjerëve
pierre angulaire	/ *gur themeli* /	diçka shumë e rëndësishme dhe e qëndrueshme që shërben si mbështetje për diçka tjetër
Un vieux routier	/ *ujk i vjetër* /	njeri i rrahur në jetë, me përvojë
pot de colle	/ *rriqër* /	njeri që u ngjitet pas të tjerëve , i bezdis
nNom de chien	/ *në dreq të mallkuar* /	përdoret për të shprehur zemërim

Shprehja frazeologjike mbiemërore

frëngjisht	shqip /	Kuptimi
cœur de citrouille	/ *zemërbutë* /	i mirë
cœur de lion	/ *zemërluan* /	trim
de façade	/ *sa për sy e faqe* /	i pasinqertë
une langue de vipère	/ *gojëlëshuar* /	që flet pa kujdes
con comme la lune	/ *rrotë nga mendja* /	i trashë nga mendja

Njësi frazeologjike të përkthyera me prafrazim apo fjalë për fjalë

Shprehja frazeologjike emërore

frëngjisht	/	shqip	/	kuptimi
bonne bête	/	*njeri jo fort i zgjuar , por i mirë*	/	njeri naiv
pot à tabac	/	*njeri i shkurtër e i shëndoshë*	/	

Shprehja frazeologjike mbiemërore

frëngjisht	/	shqip	/	Kuptimi
dur à la détente	/	koprrac	/	i vështirë për t'u bindur, koprrac
bon comme la romaine	/	i mirë, s'e bën nëna	/	shumë i mirë

Përfundimi

Studimi i aspekteve të barasvlerës strukturore dhe semantike të njësive frazeologjike me vlerë emërore dhe mbiemërore në leksikografinë frëngjisht-shqip dëshmon rëndësinë e veçantë që ka frazeologjia në pasurinë leksikore dhe në sistemin shprehës të një gjuhe. Njësitë frazeologjike përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë gjuhësore dhe kulturore, pasi përmes tyre shprehen jo vetëm kuptime të caktuara, por edhe mënyra të veçanta të konceptimit dhe të interpretimit të realitetit nga bashkësi të ndryshme gjuhësore.
Nga shqyrtimi i kësaj problematike vërehet se barasvlera strukturore dhe semantike përbën një nga çështjet më të rëndësishme në përballjen e dy sistemeve gjuhësore, siç janë frëngjishtja dhe shqipja. Edhe pse këto dy gjuhë u përkasin familjeve të ndryshme gjuhësore dhe kanë veçori të dallueshme në organizimin e tyre gramatikor e leksikor, ato shfaqin edhe përputhje të konsiderueshme në mënyrën e ndërtimit dhe të përdorimit të njësive frazeologjike. Këto përputhje dëshmojnë se përvoja njerëzore, perceptimi i botës dhe nevojat e komunikimit mund të krijojnë forma të ngjashme të shprehjes në gjuhë të ndryshme.

Referencat

[1]. Béchade, Hervé-D. (1994). Grammaire française, Paris: Presses Universitaires de France. [2]. Boissin, H. (1975).Grammaire de l´albanais moderne. Paris.
[2]. [3]. Cadiot, P. (1997). Les Prépositions abstraites en français, Paris: Armand Colin.
[3]. [4]. Çeliku, M. (2019). Parafjalët e shqipes standarde (Trajtim leksiko-semantik e gramatikor), Tiranë.
[4]. [5]. Iva Dedková, La préposition avec dans un corpus littéraire contemporain, Romanica Olomucensia 28.2 (2016): 137–151 (ISSN 1803 – 4136), pdf.
[5]. [6]. Guillaume, G. (1971). Leçons de linguistique, Québec: Les Presses Universitaires de Laval.
[6]. [7]. Injoo Choi-Jonin (La préposition “avec” : opérateur de (dé)composition), Université des Sciences Humaines Strasbourg, f. 109-129, Scolia, 5, 1995.